

01-1279



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrative të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 -154396/19 dt.02.07.2019, të kërkuësve / pronarëve, Jeton Govori, Valon Çoçaj, “Imobiliare Friuli”sh.p.k. nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektit kryesor për ndërtimi e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti “A”, “B”, “C”, “D”, “E”, “F”, “G” & “H” në kuadër të Bllokut urban “A-13”, Tipologjia e ndërtimit “B” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë të rregullt administrative me datë 20.09.2019, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuësve / pronarëve, Jeton Govori, Valon Çoçaj, “Imobiliare Friuli”sh.p.k. nga Prishtina, sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 154396/19 dt.02.07.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Objekti “A”, “B”, “C”, “D”, “E”, “F”, “G” & “H” në kuadër të Bllokut urban “A-13”, Tipologjia e ndërtimit “B” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale, nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matičan, sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - “zgjidhjes urbane”.

II. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Bllokut urban “A-13”, Tipologjia e ndërtimit “B” të Planit Rregullues “Prishtina e Re–Zona Qendër” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01 nr.035 - 186861 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar “Banim i lartë i përzier”, si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë, 01nr.035-181427 dt. 24.09.2013;

Pronarët dhe investitori për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, janë informuar përmes “Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re – Zona Qendër” me referencë nr.1682 dt.22.06.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelave të lartcekura sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr.1582-0; S=18700m²; Valon Çoçaj, Jeton Govori; “Arë e klasit 5”;
 - nr.1583-0; S=500m²; Jeton Govori; “Arë e klasit 5”;
 - nr.930-23; S=800m²; “Imobiliare Friuli”sh.p.k. “Arë e klasit 5”;
 - nr.930-79; S=400m²; “Imobiliare Friuli”sh.p.k. “Arë e klasit 5”;
 - **Totali i parcelave private: S=20400m².**
- E drejta pronësore - juridike e parcelave të lartcekura , është private dhe komunale, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale dhe evidencës kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matičan, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi jug– lindje kah drejtimi veri - perëndim, me disnivel ~15m;

eshtë përmes rrugëve lokale,

- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m² nuk ka ndërtesa ekzistuese;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të Parcelës ndërtimore të pjesës së Bllokut urban "A-13", Tipologjia e ndërtimit "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urban, kushtet për ndërtim për realizimin - ndërtimin e kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste dhe hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi & qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesave, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese & ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane" bashkangjitura vendimit kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban "A-13", Tipologjia e ndërtimit "B" planifikohet të ndërtohet Kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleks me ndërtesa shumë banesore & afariste --

Objekti, "A", "B", "C", "D", "E", "F", "G" & "H"

Objekti "A" - S=9065m² / 6590m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 11,

Objekti "B" - S= 9105m² / 6630m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 11,

Objekti "C" - S= 9575m² / 7100m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 12,

Objekti "D" - S= 10115 m² / 7640m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 13,

Objekti "E" - S=10065m² / 7590m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 13,

Objekti "F" - S=10115m² / 7640m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 13,

Objekti "G" - S=10065m² / 7590m², mbi tokë + 2475m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 13,

Objekti "H" - S=11120m² / 8700m², mbi tokë + 2420m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + S + P + 13,

Totali S= 79225m² / 59480m², mbi tokë + 19745m², nën tokë /

- Parcelat kadastrale për realizimin e kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:

- nr.1582-0; S=13256m²;
- nr.1583-0; S=142m²;
- nr.930-23; S=460m²;
- nr.930-79; S=304m²;

Sipërfaqe totale: S=14162m²;

- Pjesët e parcelave kadastrale për realizimin e kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, të trajtuara jashtë rregulluese dhe kompensuar / shpronësuar me sipërfaqe ndërtimore, janë:

- nr.1582-0; S=2368m²;
- nr.1583-0; S=28m²;
- nr.930-23; S=340m²;
- nr.930-79; S=96m²

Sipërfaqe totale: S=2832m²;

- Pjesët e parcelave kadastrale që nuk trajtohen me këtë fazë të realizimit të kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste, janë:

- nr.1582-0; S=1433 + 1341 + 302=3076m²;
- nr.1583-0; S=330m²;
- nr.930-23; S=0.00m²;

- nr.930-79; $S=0.00m^2$

Sipërfaqe totale: $S=3405m^2$;

- Etazhiteti maksimal për Bllokut urban "A-13", Tipologjia e ndërtimit "B" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", është $V \div X$ etazhe mbi tokë (sipas projekt propozimit etazhiteti maksimal është, nga $-2B+S+P+11$ gjerë $2B+S+P+13$);
- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore / parcelave kadastrale të bashkuara sipas grupeve-fazave në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë-gabarit të përdheses ose suteranit, lejohet max.40%:
 $S=14162 \times 0.4= 5664.80m^2$ / sipas planit rregullues /
 $S=5570m^2$ /sipas projekt propozimit /
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN),sipas grupeve-fazave, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në planin rregullues de paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është:
 $S=14162 \times 0.6=8497.20m^2$ / sipas planit rregullues/
 $S=8497.20m^2$ / sipas projekt propozimit/
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe hapësira me sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) min.40%, bazuar në planin rregullues dhe Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me gjelbërim të lartë & të ultë, dhe të organizuara për sport & rekreacion. Sipërfaqet gjelbëruese, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, për kompleksin është:
 $S=14162 \times 0.4=5664.80m^2$ / sipas planit rregullues dhe vendimit /
 $S=6562m^2$ /sipas projekt propozimit/
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" është max. 3.5, dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:
 $S=14162 \times 3.5=49567m^2$ / sipas planit rregullues /
 $S=59480m^2$ /sipas projekt propozimit duke llogaritur edhe kompensimin – shpronësimi /
- Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese (deri në 20% të parcelës ndërtimore) mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është $S=14162/20400 \times 100=69.42\%$, andaj bazuar në vendimin e lartë cekur sipërfaqja që mund të shfrytëzohet është $S=14162 \times 0.2(20\%) = 2832.40m^2$. Sipërfaqja e lartë cekur e kalkuluar me koeficient ndërtimi, përcakton sipërfaqen ndërtimore prej, $S=2832.40 \times 3.5=9913.40m^2$.
Bazuar në kalkulimet e lartë cekura sipërfaqja totale e lejuar ndërtimore për ndërtesat shumë banesore & afariste – Objekti "A", "B", "C", "D", "E", "F", "G" & "H" do të jetë:
 $S=49567 + 9913.40=59480.40m^2$;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016,për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë 1.0 x H (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje 0.5 x H ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, koridore të banesave, etj);
Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) te fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet distanca 0.6 x H;
- Etazhiteti maksimal i lejuar në Bllokun urban "A-13" është max. $V \div X$ kurse sipas projekt propozimit është P+11 gjer P+13 , bazuar në Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016, protokolluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e termoizolimit në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISHN), e as në kalkulimin për taksën e lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhesis nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max.1.2 m;
- Dalje / mos daljet me konzollë mbi etazhet e përdhesis në këtë bllok urban nga ana e rrugëve publike – vija ndërtimore, nuk janë të lejuara;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues për Bllokut uran “A-13”, për Tipologjinë “B”, raporti i sipërfaqeve ndërtimore, banim / afarizëm është 70% / 30%;
- Qasjet në komplekse të jenë nga rrugët e planifikuar e planit rregullues urban sipas planit të situacionit / zgjidhjes urbane ;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotualet kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.0 vend-parkime/një njësi banesore, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen vend-parkimet, për çdo 30m²/ një vend-parkime për shitore, banka, dhe të ngjashme për çdo 30m²/ një vend-parkime për hotele të parashihen
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret & parametrat urban të Plani Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”.
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

V. Ndarja / parcelimi i parcelës kadastrale, nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matigan, do të realizohet sipas Manualin e ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekura, sipas Manualit i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Kjo procedurë të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari & investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - “zgjidhja urbane” dhe “*Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01*”, punuar nga kjo drejtori, dhe Manuali i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar Ferid. Nj. Ahmeti nga Prishtina me numër të licencës nr.174, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo procedurë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.

VI. Bashkimi i pjesëve të parcelave kadastrale, nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matigan, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore, pas realizimit të procedurës të ndarjes përcaktuar në paragrafin VII. të këtij vendimi, bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, drejtorja jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të procedurave të paragrafit VII. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në

Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar nga Prishtina me numër të licencës 174, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

VII. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesëve të parcelës, nr.1582-0 me $S=2368m^2$, nr.1583-0 me $S=28m^2$, nr.930-23 me $S=340m^2$ dhe nr.930-79 me $S=96m^2$, të gjitha ZK Matigan, me sipërfaqe totale prej $S=2832m^2$ e përfshirë në hapësira publike të planifikuara – rrugë të realizohet si më poshtë:

Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private planifikuar për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja e parcelës jashtë vijës rregulluese (deri në 20% të parcelës ndërtimore) mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje(%) është $S=14162/20400 \times 100=69.42\%$, andaj bazuar në vendimin e lartë cekur sipërfaqja që mund të shfrytëzohet është $S=14162 \times 0.2(20\%)=2832.40m^2$. Sipërfaqja e lartë cekur e kalkuluar me koeficient ndërtimi, përcakton sipërfaqen ndërtimore të kompensuar prej, **$S=2832.40 \times 3.5=9913.40m^2$** .

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së mbetur të parcelës kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matigan. Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimit me sipërfaqe ndërtimore do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Trajtimi definitiv i sipërfaqeve për kompensim / shpronësim me sipërfaqe ndërtimore të mirët pas realizimit të procedurës të përshkruar në paragrafin VII. të dispozitivit të këtij vendimi;

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafit, nga bashkëpronarët & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendim të kushteve ndërtimore.

VIII. Kycja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në orto-foto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos" - Ngrohitorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej $50m$, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;

- Projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVARET 01,
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

X. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së

Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

XII. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE - meqenëse parcelat kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matëçan, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasit 5", paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=14162m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XIII. PAGESA E TAKSËS për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

XIV. Kushti i prezantimit të kontratës – marrëveshjes për bashkë investim në mes të pronarëve të parcelave kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matëçan, apo i pronarëve me investitorin duhet të realizohet me dokumentacion për aplikim për leje ndërtimi;

XV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuesit / pronarët, Jeton Govori, Valon Çoçaj, "Imobiliare Friuli"sh.p.k. nga Prishtina, me kërkesën 05nr.350/02 -154396/19 dt.02.07.2019, kanë kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – për ndërtimi e kompleksit shumë – Objekti "A", "B", "C", "D", "E", "F", "G" & "H", në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05nr.350/02 -154396/19 dt.02.07.2019, dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dokumentacioni dhe provat si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe Certifikatat e njësisë kadastrale për parcelat kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23, 930-79 ZK Matëçan, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;

- Vërtetimi i obliguesit tatimor në emër të Imobiliare Friuli Sh.p.k nr.9790/19 dt. 15.01.2019;
- Fotokopjet e letërnjoftimeve të të lartë cekurve;
- Certifikata e regjistrimit të "Imobiliare Friuli" Sh.p.k nga Prishtina 70442153;
- Akti notarial "Autorizim" i përpiluar nga Noter Isak H Ademi në Prishtinë LRP.nr.9936/18 ref.2384/18 dt.05.06.2018;
- Fotot e lokacionit;
- Projekt propozimi konceptual, hartuar nga "Aspen Architecture" Sh.p.k nga Prishtina, me projektues Dardan Metushi;
- Situacionin e terenit në parcelat nr.1582-0, 1583-0, 930-23, 930-79 Zk.Matiçan, punuar nga gjeodeti i licencuar Xhavit M Gorçaj me nr. licencës 94;
- Manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave kadastrale nr.1582-0, 1583-0, 930-23, 930-79 Zk.Matiçan, punuar nga gjeodeti i licencuar Ferid. Nj. Ahmeti me nr. licencës 174;
- Afishja "Njoftim publik" lëshuar nga kjo drejtori, nga data 15.07.2019 gjer 30.07.2019;
- Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re-Zona Qendër, me reference nr.1682 dt.24.05.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës 05nr.350/02 -154396/19 dt.02.07.2019, kërkesë për kushte ndërtimore, dokumentacionin e prezantuar me kërkesa si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurave administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumentin e planifikimit hapësinor – Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", në mënyrë kronologjike dhe procedurale, konstaton se:

Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 -154396/19 dt.02.07.2019, në fazën fillestare të sajë, në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 15.07.2019 ka vendosur afishen "Njoftimi publik" e cila ka qëndruar gjer me datë 30.07.2019, ku sipas rregullativës ligjore të lartë cekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës duhet të informohet me synimin e kërkuar dhe ofrimin e mundësin për dhënien e komenteve të pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m', por gjatë kësaj periudhe në adresën e postës elektronike të vendosur në afishe- njoftimit publik nuk ka arritur ndonjë koment.

Drejtoria e Urbanizmit pas pranimit të kërkesës së lartë cekur me dokumentacionet e bashkangjitura në kërkesa, dhe me që rast konstatoi se, parcelat e trajtuara nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matiçan, me sipërfaqe të tërësishme prej $S=20400m^2$, pjesërisht përfshihen brenda parcelës bllokut urban, që formon parcelën ndërtimore me $S=14162m^2$, pjesërisht jashtë vijës rregullues, gjegjësisht $S=6238m^2$, nga të cilat sipërfaqja prej $S=2832m^2$, do të trajtohet në ndërtim bazuar në Vendimin 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, kurse pjesa tjetër në sipërfaqe prej $S=3405m^2$, do të mbetet pa u trajtuar, gjegjësisht do të trajtohen në fazat e ardhshme.

Pjesa e parcelës kadastrale nr.1582-0 ZK Matiçan në $S=302m^2$ brenda Bllokut urban "A-13" mbetet për trajtim me parcelat kadastrale në vazhdim të këtij blloku urban, bazuar në kërkesat dhe zgjidhjet që do të prezantohen, nga pronarët dhe investitorët e atyre pronave.

Kërkuarësit e lartë cekur, me dokumentacionin e prezantuar nuk kanë prezantuar edhe marrëveshje apo kontratë për bashkë investim, andaj të njëjtit obligohen që pas pajisjes me kushte ndërtimore dhe me dokumentacion për aplikim për leje ndërtimore, të prezantojnë marrëveshjen apo kontratën, se të njëjtit jen edhe investitor, apo me një palë të tretë – investitor tjetër.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçe të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, me rrugën në mes blloqeve urbane "A-4" & "A-13", ku ndër të tjera konstatohet :

Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Jeton Govori, Valon Çoçaj, me Investitor "Imobilare Friuli" sh.p.k., Prishtina e re zona qendër, Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-154396/19 dt.02.07.2019, kyçja për automjete në rrugë të planifikuar

të paraparë me këtë zgjidhje për Ndërtesën "A" me etazhitet 2B+S+P+11, Ndërtesën "B" me etazhitet 2B+S+P+11, Ndërtesën "C" me etazhitet 2B+S+P+12, Ndërtesën "D" me etazhitet 2B+S+P+13, Ndërtesën "E" me etazhitet 2B+S+P+13, Ndërtesën "F" me etazhitet 2B+S+P+13, Ndërtesën "G" me etazhitet 2B+S+P+13 dhe Ndërtesën "H" me etazhitet 2B+S+P+13, në Lagjen Prishtina e re Zona Qendër, Prishtinë, mund të pranohet si e tillë, marr parasysh shmangien e kësaj zgjidhje. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimi në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kësaj. Gjerësia e rrugës kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuara sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesave banimore afariste nuk duhet të ketë. Kësaj duhet të harmonizohet dhe të përshtatet me profilin e rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo.

Pas konstatimeve të lartë shënuara, dokumentacionit të shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, është konstatuar se, bazuar në nenin 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", është prezantuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe "zgjidhja urbane" e propozuar është në harmoni me kriteret e planit rregullues urban, andaj u vendos që me vendim të caktohen Kushtet ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelave kadastrale në raport me rrugët e planifikuara, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga Planit Rregullues "Prishtina e re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KosovaREF 01; Manuali i ndarjes dhe bashkimit të parcelave, nr.1582-0, 1583-0, 930-23 dhe 930-79 ZK Matëchan.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me vendimin e kushteve ndërtimore, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Kërkesuesve, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 154396/19 dt.02.07.2019.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 154396/19 DT. 20.09.2019

Zyrtari:
Ergyn Hajredini



U.D. Udhëheqëse e Sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 07.08.2019

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- - - Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale



Biloku Urban "A13"	SIPERFAQET E PLANIFIKUARA									
	Objekti	A	B	C	D	E	F	G	H	A-H
	Nentoka	2,475.00	2,475.00	2,475.00	2,475.00	2,475.00	2,475.00	2,475.00	2,420.00	19,745.00
	Banim	5,525.00	5,565.00	6,035.00	6,575.00	6,525.00	6,575.00	5,025.00	0.00	41,825.00
	Afarizem	1,065.00	1,065.00	1,065.00	1,065.00	1,065.00	1,065.00	2,565.00	8,700.00	17,655.00
	Total	9,065.00	9,105.00	9,575.00	10,115.00	10,065.00	10,115.00	10,065.00	11,120.00	79,225.00

Përbajtja/Content: Prishtina e re - Biloku A13	Lokacioni/Location: Prishtinë	Destinimi/Application: Kompleks shumebanësor & afarist	Emërtimi/Drawing name: Situacioni i gjere		Veriu/ North :
Faza e Planifikimi/Planning Phase: Projekt Idëor	Investitori/Cient: Jeton Govori, Valon Çoçaj, "Imobiliare Friuli" SH.P.K.	Etazhiteti/Levels:	Përpjesa/Scale:		
ASPEN ARCHITECTURE a: rr. Abedin Rexha #100 Prishtinë p: +383 45 680 750 e: info@aspens-architecture.com w: aspens-architecture.com	Projektoi/Designed by: Dardan METUSHI M. arch. Ermal BUÇINCA M. arch.		Data/Date: Korrik, 2019	Revidimi/Revision: 1	Formati/Format: A3
	Punoi/Drawn by: Egzona ELEZA J. M. Arch. cand. Xhezide VLASHI B. Arch.		Projekti Nr./Project Nr.: #19-69		Fleta Nr./Page Nr.: A.07



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice :01582-0
01583-0,00930-79,00830-23

Numri i lëndës / Broj predmeta: /2019

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000



Prishtinë

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija:

Zona kadastrale / Katastarska zona: Matičan

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Propozim për bashkim dhe ndarje të parcelave.



Rilevoi / Snimio: Ferid Nj.Ahmeti
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 174

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 09.08.2019

Aprovoi / Usvojio:

(emri dhe mbiemri i përsorit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja:

